**VENDIM**
**Nr.946, datë 2.9.2009**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KRUMË TË QARKUT TË KUKËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Krumë të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 72 fletë (shtatëdhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Krumë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Bashkia Krumë — Lidhja nr.1

| **Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 4,5,17,18,19,21,24-28 | Prona që përdoren në fushën administrative. | Në pronësi |
| 35-48 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 49-52,54,256-289,294-302, 303-324 | Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturës. | Në pronësi |
| 55,57,58,59,60-62 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). | Në përdorim |
| 56,63,64/8,65/3,66/2 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta). | Në pronësi |
| 185-203 | Shërbim funeral | Në pronësi |
| 204-222 | Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile. | Në pronësi |
| 248,252-255 | Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik. | Në pronësi |
| 325-339 | Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore e sportive. | Në pronësi |
| 362-363 | Prona që përdoren për furnizimin me ujë të pijshëm. | Në pronësi |
| 365 | Prona që përdoren në fushën e ndriçimit | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| | publik. | |
| 364 | Troje të lira | Në përdorim |
| 340-358,364 | Infrastrukturë vendore, sheshe, lulishte, trotuare (në pronën 364 nuk transferohen trojet e lira). | Në pronësi |